



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.237/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi-anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, e paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë,

### V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e parashtruar nga kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ZL.Anr.237/2025, e datës 17.10.2025, e paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

### A r s y e t i m

Me datën 17.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, të dorëzuar përmes postës me datë 14.10.2025, me të cilën pretendon se me datë 12.10.2025, ditën e zgjedhjeve dyshohet se dy persona që janë të burgosur në Maqedoni si Granit Luri dhe Blend Luri, figurojnë se kanë votuar në Secishte, në vendvotimin numër 2 (3304-2), duke shtuar se sipas ligjit çdo person duhet të jetë fizikisht prezentë në vendvotim për të votuar. Kanë kërkuar nga PZAP që Komuna e Hanit të Elezit të kthehet në rivotim.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me datë 18.10.2025, ka deklaruar sesa përket pretendimeve të paraqitura në ankesë të paraqitura nga kandidati i pavarur për kryetar të komunës, Rufki Suma, i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë, apo dëshmi për të vërtetuar pretendimin e tij. Tutje, kanë shtuar se në qendrën e votimit ku pretendon se ka ndodhur parregullsia, kanë qenë tre komisioner të parashtruesit të ankesës, dhe asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar ndonjë ankesë ose kundërshtim lidhur me procesin e votimit, të cilën e ka konfirmuar edhe kryesuesi i KKZ-së në Han të Elezit, Enver Suma. Kanë theksuar që kërkesa që të vërtetohen pretendimet nga PZAP, është e paarsyeshme për faktin se parashtruesi nuk ka ofruar asnjë bazë faktike, ashtu që kane kërkuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa. Si provë kanë bashkangjitur përgjigjen e kryesuesit të KKZ-së, Enver Suma.

Në përgjigjen në ankesë KQZ ka deklaruar se pas pranimit të ankesës nga PZAP më datën 17.1.2025, kanë kontaktuar me KKZ, të Hanit të Elezit, nga i cili kanë marrë përgjigjen dhe konfirmimin si më poshtë: “Pas shqyrtimit të ankesës se në Qendrën e Votimit 3304/02, Secishte kanë votuar dy persona të cilët janë të burgosur në Maqedoni. KKZ i Hanit të Elezit si trup zgjedhor dhe akteret e tjerë zgjedhor si Menaxheri Qendrave të votimit dhe Këshillat e vendvotimeve nuk kanë deklaruar dhe nuk janë ankuar për asnjë moment në lidhje me

pretendimet për probleme dhe parregullsi zgjedhore në këtë Qendër të Votimit. Ju kujtoj që në këtë vendvotim 3304/02 sikurse në të gjitha vendvotimet e tjera kandidati i pavarur ( Rufki Suma) ka pasur 3 komisioner (LVV, AAK dhe komisioneri i KP dhe 3 vëzhgues të cilët kanë qenë përkrahësit e tij sipas marrëveshjes së tyre), asnjëri prej këtyre 6 persona nuk është ankuar se ka ndodhur ky rast, të paktën njëri prej tyre kishte reaguar bile edhe fuqishëm nëse kishte ndodhur. KVV dhe menaxheri i kësaj Qendre nuk është ankuar. Andaj në si KKZ iu sigurojmë që procesi zgjedhor i mbajtur më datë 12.10.2025, ka qenë i rregullt, i sigurt dhe transparent, i vëzhguar nga kamerat e vendosura në çdo vendvotim po ashtu edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike dhe të atyre ndërkombëtare”. Tutje KQZ kanë deklaruar se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështetësin pretendimet e saj paraqitura në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, vëren se ankesa është e pabazuar. Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë dhe se kanë nënshkruar persona të cilët janë në burgim, e të cilët nuk kanë qenë prezent në vendvotime. Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtuesi i ankesës nuk ka mbështetur pretendimet e tij me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se kanë nënshkruar persona të cilët janë në burgim, e të cilët nuk kanë qenë prezent në vendvotime.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, të cilën e ka konfirmuar edhe kryesuesi i KKZ-së i Komunës së Hanit të Elezit, Enver Suma me përgjigjen e datës 17.10.2025, në të cilën konstaton se “KKZ i Hani i Elezit gjatë gjithë kohës ka qenë në vizita nëpër Qendra të Votimit dhe askush nga KVV dhe menaxheri i kësaj qendre nuk është ankuar, votimi ka qenë i rregullt, i sigurt dhe transparent, i vëzhguar nga kamerat e vendosura në çdo vendvotim po ashtu edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike dhe të atyre ndërkombëtare.” Në këtë kuptim Paneli vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtuara me ankesë sepse ankuesi nuk ka bashkëngjitur asnjë provë të vetme, dhe as në Librin e Evidencës nuk është evidentuar asnjë vërejtje, me të cilën do të dëshmohej se ka ndodhur parregullsia e pretenduar.


Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë, ankuesi nuk ka arritur që ti provoj me asnjë prove të vetme.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
ZL.Anr.237/2025 datë 20.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.96/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar, Delushe Halimi dhe Nenad Lazic, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.237/2025, të datës 20.10.2025, në seancën e mbajtur më datë 24.10.2025, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZL.Anr.237/2025, të datës 20.10.2025.

### A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZL.Anr.237/2025, të datës 20.10.2025, është vendosur: "Refuzohet e pabazuar ankesa e parashtruar nga kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ZL.Anr.237/2025, e datës 17.10.2025, e paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe Rregullores Zgjedhore 12/2024, vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma si të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin ZL.Anr.237/2025, të datës 20.10.2025, ashtu që të urdhëroj verifikimin e drejtpërdrejtë të librave origjinalë të votimit për Komunën e Hanit të Elezit, si dhe të konstatojë se votimi i personave të burgosur përbën shkelje të nenit 45 paragraf 2 të Kushtetutës dhe nenit



6 paragraf 2 të Ligjit, si dhe përbënë veprë penale në kuptim të nenit 213 të Kodit Penal të Kosovës.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.Anr.237/2025, të datës 20.10.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 17.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, të dorëzuar përmes postës me datë 14.10.2025, me të cilën pretendon se me datë 12.10.2025, ditën e zgjedhjeve dyshohet se dy persona që janë të burgosur në Maqedoni si Granit Luri dhe Blend Luri, figurojnë se kanë votuar në Seçishte, në vendvotimin numër 2 (3304-2), duke shtuar se sipas ligjit çdo person duhet të jetë fizikisht prezentë në vendvotim për të votuar, andaj ka kërkuar nga PZAP që Komuna e Hanit të Elezit të kthehet në rivotim.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me datë 18.10.2025, ka deklaruar se sa i përket pretendimeve të paraqitura në ankesë të paraqitura nga kandidati i pavarur për kryetar të komunës, Rufki Suma, i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë, apo dëshmi për të vërtetuar pretendimin e tij. Tutje, kanë shtuar se në qendrën e votimit ku pretendon se ka ndodhur parregullsia, kanë qenë tre komisioner të parashtruesit të ankesës, dhe asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar ndonjë ankesë ose kundërshtim lidhur me procesin e votimit, të cilën e ka konfirmuar edhe kryesuesi i KKZ-së në Han të Elezit, Enver Suma. Kanë theksuar që kërkesa që të vërtetohen pretendimet nga PZAP, është e paarsyeshme për faktin se parashtruesi nuk ka ofruar asnjë bazë faktike, ashtu që kanë kërkuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa. Si provë kanë bashkangjitur përgjigjen e kryesuesit të KKZ-së, Enver Suma.

Pas pranimi të përgjigjes në ankesë të KQZ, PZAP më datën 17.10.2025, kanë kontaktuar me KKZ, të Hanit të Elezit, nga i cili kanë marrë përgjigjen dhe konfirmimin si më poshtë: "Pas shqyrtimit të ankesës se në Qendrën e Votimit 3304/02, Secishte kanë votuar dy persona të cilët janë të burgosur në Maqedoni. KKZ i Hanit të Elezit si trup zgjedhor dhe akteret e tjerë zgjedhor si Menaxheri Qendrave të votimit dhe Këshillat e vendvotimeve nuk kanë deklaruar dhe nuk janë ankuar për asnjë moment në lidhje me pretendimet për probleme dhe parregullsi zgjedhore në këtë Qendër të Votimit. Ju kujtoj që në këtë vendvotim 3304/02 sikurse në të




gjitha vendvotimet e tjera kandidati i pavarur (Rufki Suma) ka pasur 3 komisioner (LVV, AAK dhe komisioneri i KP dhe 3 vëzhgues të cilët kanë qenë përkrahësit e tij sipas marrëveshjes së tyre), asnjëri prej këtyre 6 persona nuk është ankuar se ka ndodhur ky rast, të paktën njëri prej tyre kishte reaguar bile edhe fuqishëm nëse kishte ndodhur. KVV dhe menaxheri i kësaj Qendre nuk është ankuar. Andaj në si KKZ iu sigurojmë që procesi zgjedhor i mbajtur më datë 12.10.2025, ka qenë i rregullt, i sigurt dhe transparent, i vëzhguar nga kamerat e vendosura në çdo vendvotim po ashtu edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike dhe të atyre ndërkombëtare". Tutje KQZ kanë deklaruar se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështetësin pretendimet e saj paraqitura në ankesë. Andaj PZAP, Ka nxjerrë vendimin ZL.Anr.237/2025, të datës 20.10.2025, me të cilin ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, ka ardhë në përfundim se ankesa është e pabazuar. Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë dhe se kanë nënshkruar persona të cilët janë në burgim, e të cilët nuk kanë qenë prezent në vendvotime. Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesi i ankesës nuk ka mbështetur pretendimet e tij me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se kanë nënshkruar persona të cilët janë në burgim, e të cilët nuk kanë qenë prezent në vendvotime.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, të cilën e ka konfirmuar edhe kryesuesi i KKZ-së i Komunës së Hanit të Elezit, Enver Suma me përgjigjen e datës 17.10.2025, në të cilën konstaton se "KKZ i Hani i Elezit gjatë gjithë kohës ka qenë në vizita nëpër Qendra të Votimit dhe askush nga KVV dhe menaxheri i kësaj qendre nuk është ankuar, votimi ka qenë i rregullt, i sigurt dhe transparent, i vëzhguar nga kamerat e vendosura në çdo vendvotim po ashtu edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike dhe të atyre ndërkombëtare." Në këtë kuptim Paneli ka vlerësuar se janë të paqëndrueshme pretendimet e parashtruara me ankesë, sepse ankuesi nuk ka bashkëngjitur asnjë provë të vetme, dhe as në Librin e Evidencës nuk është evidentuar asnjë vërejtje, me të cilën do të dëshmohej se ka ndodhur parregullsia e pretenduar. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë, ankuesi nuk ka arritur që ti provoj me asnjë prove të vetme.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të



Elezit, Rufki Suma, për shkak të parregullsive të pretenduara për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore 12/2024. Kjo për faktin se në këtë rast nuk ka rezultuar se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cilat i ka pretenduar ankuesi në ankesë, respektivisht se në librat origjinal të vendvotimit në Qendrën Komunale të Numërimit në Han të Elezit, kanë nënshkruar persona të cilët janë në burgim, e të cilët nuk kanë qenë prezent në vendvotime, me pretendim se PZAP në kuptim të neneve 115 dhe 120 të LZP-së, ka kompetencë të hetoj dhe të kërkoj prova shtesë për përsëritjen e votimit. Gjykata Supreme pretendimet e tilla i ka vlerësuar të pabazuara, kjo për faktin se të njëjtat nuk janë mbështetur në prova bindëse të cilat do të vërtetonin shkeljet e supozuara, respektivisht ankuesi kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, vetëm ka cituar dispozitat e LZP-së, respektivisht nenet 6 dhe 89 të këtij ligji si dhe Rregulloren Zgjedhore 12/2024, respektivisht nenet 6 dhe 10 të kësaj rregulloreje, mirëpo në këtë rast nuk mjafton vetëm citimi i dispozitave të lartcekura nga ankuesi, mirëpo duhet që me prova konkrete të vërtetohet saktë parregullsia apo shkelja e pretenduar.

Gjykata Supreme vlerëson se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi që do të mund të vërtetonin shkeljet e lartcekura, kjo duke marrë për bazë edhe nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili ka përcaktuar se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", mirëpo ankuesi, kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, nuk ka arritur të provoj faktin se në qendra të votimit kanë nënshkruar persona të cilët janë në burgim, e të cilët nuk kanë qenë prezent në vendvotime. Për më tepër edhe nga vet kryesuesi i KKZ-së i Komunës së Hanit të Elezit, Enver Suma, me përgjigjen e datës 17.10.2025, është theksuar se: "KKZ i Hani i Elezit gjatë gjithë kohës ka qenë në vizita nëpër Qendra të Votimit dhe askush nga KVV dhe menaxheri i kësaj qendre nuk është ankuar, votimi ka qenë i rregullt, i sigurt dhe transparent, i vëzhguar nga kamerat e vendosura në çdo vendvotim po ashtu edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike dhe të atyre ndërkombëtare." Andaj në mungesë të dëshmimit të parregullsive në qendra të votimit edhe janë vlerësuar të pabazuara pretendimet në ankesë lidhur me shkelje, respektivisht se shumë persona kanë votuar në emër të personave të tjerë, mes tyre edhe Granit Luri dhe Blend Luri, për të cilët është pretenduar se janë të burgosur në Maqedoninë e Veriut, kjo pasi që as në Librin e Evidencës nuk është evidentuar asnjë vërejtje, me të cilën do të dëshmohej se ka ndodhur parregullsia e pretenduar.

Gjykatës Supreme e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të PZAP-it kjo pasi që përveç se ankuesi nuk ka arritur të provoj parregullsitë për shkeljet e lartcekura në zgjedhjet lokale të 12 Tetorit 2025, po ashtu janë vlerësuar të paqëndrueshme edhe pretendimet tjera për shkelje nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, (procesi i drejtë), nenit 13 të KEDNJ-së ( e drejta për zgjedhje efektive) dhe nenit 2 paragraf 3 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, që detyrojnë shtetin të siguroj mjete efektive për çdo shkelje të të drejtave themelore, kjo pasi që shkeljet e tilla të pretenduara nga ankuesi nuk bazohen në dëshmi të qarta dhe bindëse, që do të mund të ndikonin në vendosjen ndryshe nga çka ka



vendosur PZAP, andaj edhe Gjykata Supreme e ka pranuar vendimin e saj dhe i ka refuzuar të pathemelta pretendimet e ankuesit në këtë drejtim.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e ankuesit për formën dhe përmbajtjen e vendimit janë të pabazuara, për faktin se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kolegji i kësaj gjykate konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
AA.nr.96/2025, datë 24.10.2025

Kryetari i kolegjit,

Faton Bajrami



Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

  
Funëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik



GIYKATA SUPREME E KOSOVËS

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Sheji i shkresës  
Oznaka spisa:

AD-96/2025

FILETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNIKA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, I cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e kësaj detyrë të bëhet dorëzimi I sa pas tënjes së lapshërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendur në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqini, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena odslom članu domaćin. Primoca nastojniku zgrace susjedn licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtarit i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (dikje e ngjitur në detyrë e banesës ose të lokalitit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca ( približno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më \_\_\_\_\_ 201 \_\_\_\_\_ në ora \_\_\_\_\_ ças,

Shkaku i refuzimit të marrjes \_\_\_\_\_

Razlog odbijanja prijma \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Emri i shkresës që dorëzohet:  
Naslov pisma koja se dostavlja:  
AKTIVIZIZACIJA  
24.10.2025

Numbri i shkojcave: \_\_\_\_\_  
broj priloga \_\_\_\_\_

Vendetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjaltë)

Povdujemo prijem gorenavegenog pisma (i slovina)

24.10.2025 24.10.2025  
(Nënshkrimi i marrësit ose i anëtarit që e ka marrë aktin në vend të tij  
Potpis primaoca ili licn kole je pismeno primio u znanu) 24.10.2025

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ato je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.